



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 348/11 Prot.

Vlorë, më 13. 02. 2020

VENDIM

Nr. 14, datë 13. 02. 2020

PËR

RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT "BACHELOR" NË "DREJTËSI" NË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, "MASTER I SHKENCAVE" NË "DREJTËSI", NË UNIVERSITETIN 'ISMAIL QEMALI', VLORE

Mbështetur në shkronjën b, të pikës 3, në nenin 75, nenin 82, shkronjën dh, të pikës 1, në nenin 49 në Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin nr. 1, datë 14.01. 2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", si dhe mbështetur në Vendimin nr. 52, datë 29. 01. 2020 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 13. 02. 2020

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Drejtësisë me nr. 348 prot., datë 12.11.2019 për riorganizim të programit "Bachelor" në "Drejtësi" në program të integruar të ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave" në "Drejtësi" në përshtatje me ndryshimet ligjore që parashikojnë riorganizimin e këtij programi studimi nga program i ciklit të parë të studimeve me 180 kredite në program të integruar studimi të ciklit të dytë me 300 kredite.
2. Ky program studimi parashikohet të zbatohet për vitin akademik 2020-2021 pas urdhrimit të miratimit nga MASR.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anjeza Shiko – Anëtar

Rajmonda Simoimeri – Anëtar

Enrik Mehmeti – Anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj – Anëtar

Dr. Enida Pulaj – Anëtar

Dr. Marinela Muço – Anëtar

Ervis Moçka – Kryetar

